

FJALË PËRSHËNDETËSE

Të nderuar të pranishëm!

Në planet e punës së Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë prej disa vjetësh ishte parashikuar organizimi i një konference shkencore kushtuar Etëhem Haxhiademit, njërit nga personalitetet përfaqësuese të letërsisë dhe të kulturës sonë kombëtare, por që fatkeqësisht nuk e ka marrë vëmendjen e duhur të shkencave albanologjike e më gjerë dhe që nuk është vendosur ende në vendin që i përket.

Më në fund, me kujdesin e posaçëm të përgjegjësës së Departamentit të Studimeve letrare prof. as. dr. Evalda Paci, të dr. Arian Leka, si dhe të sekretarit shkencor të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akad. Shaban Sinani, organizimi i kësaj konference u bë i mundur dhe ajo tani po fillon punimet, për të cilat jam besimplotë se do të përfundojnë me sukses. Kualiteti shkencor i punës suaj shumëvjeçare dhe serioziteti me të cilin ju i vlerësoni dhe veprimtari të tilla si kjo e sotmja, nuk e vë në dyshim edhe këtë sipërmarrje.

Më lejoni që në emër të Drejtorisë së Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë të përshëndes të gjithë të pranishmit, ardhur nga Akademia e Shkencave, nga universitete e qendra kërkimore e studimore në Kosovë, nga universitete e qendra kërkimore e studimore në Shqipëri (Tiranë, Shkodër, Elbasan, Durrës, Korçë etj.).

Të nderuar të pranishëm, Etëhem Haxhiademi lindi në Elbasan në vitin 1902 dhe u largua nga jeta në vitin 1965. Ai vjen nga një familje me tradita të përdalluara patriotike. Shkolloi në

vendlindje, në Normalen e Elbasanit, në Leçe të Italisë, në Insbruk të Austrisë, në Berlin të Gjermanisë dhe diplomohet në shkencat politike-juridike në vitin 1924 në Vjenë të Austrisë. Kthehet në Atdhe në vitin 1927 dhe punon në administratën shtetërore të kohës. Për shkak të angazhimit në vitet e Luftës në organizatën “Balli Kombëtar”, dënohet pas Çlirimit me vdekje, dënim i cili iu kthye në me burgim të përjetshëm.

Etëhem Haxhiademi njihet, jo vetëm si shtetar, politikan etj., por dhe si krijues (dramaturg e poet), përkthyes e publicist. Ai është përfaqësuesi i rrymës letrare të klasicizmit në letërsinë shqipe, u bë themeluesi i një lloji të veçantë të dramaturgjisë shqiptare dhe është cilësuar si më i miri dramaturg i periudhës midis dy luftërave. Zotëronte krahas gjuhës amtare edhe greqishten e vjetër, latinishten, turqishten, italishten, gjermanishten, frëngjishten, anglishten e rusishten. Kur ishte 20 vjeç, më 1922, përktheu “Bukoliket” e Virgjilit dhe në vazhdim: shkruan më 1924 tragjedinë “Ulisi” (Berlin); më 1926 tragjedinë “Akili” (Vjenë); më 1928 tragjedinë “Aleksandri”; më 1934 tragjedinë “Pirrua”; më 1935 tragjedinë “Skënderbeu”; më 1938 tragjedinë “Diomedi”, më 1937 tragjedinë “Abeli” 1939, më 1937 paraqet për botim vëllimin poetik “Lyra” (botuar më 1939).

Në burg u mor me përkthime si dhe ka të dhëna se shkroi romanin “Jeta e njeriut” dhe dramën “Koha e premtueme”, që kanë mbetur sot e kësaj vepra të panjohura.

Njihet si një nga shkrimtarët që punoi me pasion të jashtëzakonshme me shqipen dhe luftoi me përkushtim për pastërtinë e saj.

Vlerësimet për krijimtarinë e tij janë bërë nga studiues e figura të njohura të letrave shqipe si Branko Merxhani, Vangjel Koça, Lasgush Poradeci, Jup Kastrati, Sterjo Spasse, Vedat Kokona etj., dhe pas viteve ’90 nga Aurel Plasari, Tomorr Plangarica, Bardhyl Matraxhiu, Robert Elsie etj.

Të nderuar pjesëmarrës të Konferencës shkencore mbarëkombëtare “Dramaturgu-poet Etëhem Haxhiademi, në

fokusin e trajtimeve letrare dhe gjuhësore”, mjafton t’u hedhësh një sy temave të kumtesave që do të referohen sot, për të parë vlerat e shumëfishta të veprës së këtij personaliteti, por dhe përgjegjësinë e aftësinë e secilit prej jush për t’iu qasur kësaj vepre nga këndvështrime e prerje të ndryshme shkencore. Kjo do të bëjë që figura e dramaturgut-poet të rivlerësohet në shumanshmërinë e vet, por të krijohen dhe hapësira e mundësi për t’iu qasur asaj edhe më gjerë, më thellë e më plotërisht në të ardhmen!

I uroj sukses konferencës, ju falënderoj edhe njëherë për vlerësimin që i bëtë asaj duke qenë të pranishëm jo vetëm me punimet tuaj shkencore, por edhe fizikisht në këto kohë të vështira pandemie.

Prof. dr. Valter MEMISHA,
Drejtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, ASA.
Tiranë, 25 qershor 2021

